



(22) По влегувањето во сила на подзаконскиот акт истиот веднаш, а најдоцна во рок од 24 часа се објавува на веб страницата на Институтот.“

### Член 3

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

## L I G J PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REVIZION

### Neni 1

Në Ligjin për revizion ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 158/10), në nenin 26 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Formen dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, e përcakton ministri i Financave."

### Neni 2

Në nenin 27 pas paragrafit (4) shtohen 18 paragrafë të rinj (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19), (20), (21) dhe (22), si vijojnë:

"(5) Nese Institutit nuk lëshon certifikatë për revizor në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, personi që e ka dhënë provimin ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës nga kalimi i këtij afati të parashtrijë kërkesë në sekretarinë e kryetarit të Institutit, për lëshim të certifikatës.

(6) Formen dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni, i përcakton ministri i Financave.

(7) Kryetari i Institutit detyrohet që ta lëshojë certifikaten, më së voni në afat prej pesë ditëve të punës nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni. Nëse kryetari i Institutit nuk ka sekretari, kërkesa parashtrijë në sekretarinë e selisë së Institutit.

(8) Nese kryetari i Institutit nuk e lëshon certifikatën në afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, personi mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(9) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (8) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në Institut dhe të konstatojë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta njoftojë personin për masat e ndermarra.

(10) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nga paragrafi (9) i këtij neni, pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e ngarkon kryetarin e Institutit që në afat prej dhjetë ditësh ta lëshojë certifikaten dhe në afatin e njëjtë ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet ekzemplar i aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(11) Nese kryetari i Institutit nuk e lëshon certifikatën në afatin nga paragrafi (10) i këtij neni, inspektori do të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin kryetari i Institutit do të vendosë për kërkesen e paraqitur, për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzo-

het kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e njofton parashtruesin e kërkesës për masat e ndermarra.

(12) Nese kryetari i Institutit nuk e lëshon certifikatën as në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndermarra.

(13) Nese inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (9) i këtij neni, personi në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të parashtrijë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrijë në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(14) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditëve të punës ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (13) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga personi në pajtim me paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni ose nuk ka paraqitur kallëzim në pajtim me paragrafët (12) dhe (13) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në Institut nëse procedura është zbatuar në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë personin për masat e ndermarra.

(15) Nese inspektori nuk vepron as në afatin plotësues nga paragrafi (14) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta njoftojë personin për masat e ndermarra.

(16) Në rastin nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(17) Në rastin nga paragrafi (16) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës do ta njoftojë personin për masat e ndermarra.

(18) Nese drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhje me paragrafin (14) të këtij neni, personi mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(19) Nese kryetari i Institutit nuk vendos në afatin nga paragrafi (12) i këtij neni, personi mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(20) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(21) Akti nënligjor nga paragrafi (5) i këtij neni, do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e ketij ligji.

(22) Pas hyrjes në fuqi të aktit nënligjor, ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Institutit."

### Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".